



Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Pastertia" Sh.a.Ferizaj, mbështetur në nenin 8,10 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenin 5 paragrafin 2 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2024, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Nenin 16 të Statutit të Kompanisë shpall :

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Për vendin e punës :

Nr.Referencës	Pozita	Institucioni	Njësia	Koeficienti -Paga:	Kohëzgjatja e kontratës:	Vend i lirë/Zëvendësim	Nr. Pozitës
1-5632/2024	Kontroll Tereni	KRM Pastertia Sh.A Ferizaj	Ferizaj	430.00	Kohë të caktuar	Vend i lirë	2
2-5632/2024	Arkatar	KRM Pastertia Sh.A Ferizaj	Ferizaj	410.00	Kohë të caktuar	Vend i lirë	1

Përgjegjësi mbikqyrëse : Jo

Raportimi: Urdhëresave të lëmive përkatëse

Orari i plotë i punës: Po

Kohëzgjatja e emërimit : Në kohë të caktuar / Puna Provuese gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës dhe Aktin e Breshëm të Punëdhënësit

Koeficientet : Në harmoni me politikat zhvillimore të Kompanisë

Vendi i punës : Ferizaj.

Dokumentet e kërkuara:

- Aplikacioni i punësimit;
- Dokumenti i identifikimit të skenuar;
- Letër Motivuese (CV);
- Diplomen mbi kualifikimet të cilat i posedojnë;
- Dëshmin e përvojës në punë;
- Certifikat nga gjykata që nuk është l/ e dënuar apo në procedure penale jo më të vjetër se 3muaj;
- Çdo dokument tjetër që e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të caktuara më lartë.
- Kandidati i cili arrin pikët e mjaftueshme pwr pranim, është i obliguar të sjellin Certifikatë Shëndetësore

- Të gjitha dokumentet e lartëcekura duhet të skenohen nga origjinali në formën PDF dhe të dërgohen ne email adresën Zyrtare të Kompanisë të Burimeve Njerzore - hr-pastertia@hotmail.com.

Përshkrimi I vendit të punës dhe përvoja e punës:

Kontroll Tereni:

Përgjegjësitë dhe Detyrat: Kontrollon tërë zonën e shërbimit. Në rast të moskryerjes efikase të punëve nga ana e punëtorëve në teren, konstaton me përgjegjësit e drejtëpërdrejtë të Operativës në mënyrë që të evitohen dobësitë eventuale. Merr vërejtjet eventuale nga klientët dhe dhe të njejtet i paraqet te kompetentët e kompanisë. Kryen punët dhe detyrat e punës sipas urdhëresës së udhëheqësit të drejtëpërdrejtë dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Dëshmia për kualifikim: Diplomën e Shkollës së Mesme.

Arkatar:

Përgjegjësitë dhe Detyrat: Kryen të gjitha pagesat e konsumatorit me para të gatshme dhe transaksione me kartela bankare, përgjegjëse për arkën e përcaktuar, bënë barazimin ditor të arkës dhe dorëzimin e saj, përveç detyrave dhe përgjegjësive të cekura, kryen punët dhe detyrat e punës sipas urdhëresës së udhëheqësit të drejtëpërdrejtë dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Dëshmia për kualifikim: Diplomë e shkollës së mesme.

Mënyra e Aplikimit:

- Aplikacioni mund të merret në zyret e KRM "Pastertia" Sh.A. Ferizaj, në Fshatin Gërllicë , por mund të shkarkohet edhe në web-faqen e Kompanisë: www.pastertia.com.
- Aplikimi për konkursin e shpallur bëhet vetëm në mënyrë elektronike në emailin hr-pastertia@hotmail.com

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik:

- Lista e kandidatëve të cilët i plotësojn kushtet për pranim do të shpallet në tabelën e shpalljeve të KRM Pastertia Sh.A Ferizaj, gjithashtu kandidatët do të njofohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi, duke respektuar Udhëzimin Administrativ 01/24 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikacionit të kandidatit:

- Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë,
- Intervista verbale vlerësohet deri në njëzet (20) pikë
- Përshkrimi i përvojës së punës apo (CV)-ja vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë.

Kalendari i përafërt i procedurave të rekrutimit:

- Brenda 25 ditësh do të organizohet testi me shkrim, mbrenda 25 ditësh do të organizohet intervista me gojë dhe njoftimi final mbrenda 30 ditë nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas U.A. nr. 01/2024.

Vërejtje:

Kompania Pastertia ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi i jashtëm mbetet i hapur (15) ditë nga data e publikimit në web faqen e Kompanisë si dhe në tabelën e njoftimeve të Kompanisë, duke filluar nga data **13.12.2024 deri 30.12.2024** deri në ora **16:00**.

Aplikacionet e kandidatëve të pakompletuara do të refuzohen, dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Për informata shtesë mund të kontaktoni numrin e tel. 0290/325-025 ose ne email adresen hr-pastertia@hotmail.com.

Datë,
13.12.2024

KRM "Pastertia" Sh.A Ferizaj


BASRI SULA